



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 610 / prot.
5

Tiranë, më 24.4.2026

V E N D I M

Nr. 15, datë 24.4.2026

PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË RREGULLOREN E BRENDSHME TË
SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Në mbështetje të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 24.4.2026.

V E N D O S I:

Të bëhen këto shtesa e ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, të miratuar me vendimin nr.1, datë 31.1.2017, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

1. Neni 48 "Programi i Formimit Vazhdues" ndryshon si vijon:

1.1 Në nenin 48, pika 8, paragrafi i pare, shtohet koordinatori i modulit/fushës:

"Për identifikimin e një programi tematik adekuat, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Drejtori i Shkollës, koordinatorët e moduleve/fushave dhe personat përgjegjës për Formimin Vazhdues (FV), koordinojnë dhe ndjekin metoda shkencore të vlerësimit të nevojave përmes:..."

1.2 Shtohet pika 8.1 me këtë përmbajtje:

"8.1 Koordinator i modulit harton një projekt përshkrim të modulit, ose grupit të temave në një fushë të caktuar. Përshkrimi i modulit duhet të përmbajë:

- analizë të nevojës për ta pasur këtë modul pjesë të programit të formimit vazhdues;
- synimin dhe objektivat që duhet të përmbushë ky modul;
- temat që do të përfshihen në modul, së bashku me arsyetimin e ndërlidhjes mes tyre dhe bazën e çështjeve kryesore që duhet të përmbajë secila temë;
- subjektet të cilat ju drejtohet ky modul dhe/ose tema të caktuara pjesë e modulit;
- kohëzgjatjen e modulit;
- përshtatshmërinë ose jo për të qenë rajonal;

g) propozime për ekspertë/lehtësues nëse ka.”

1.3 Shtohet pika 8.2 me këtë përmbajtje:

“8.2 Të paktën 1 anëtar i Këshillit Pedagogjik, i caktuar nga Këshilli Pedagogjik, ka përgjegjësinë të vlerësojë projektin e dorëzuar nga koordinatori i modulit, të komunikojë drejtpërdrejtë me koordinatorin e modulit në rast nevoje për rishikim dhe variantin përfundimtar t’ia paraqesë Pedagogut Përgjegjës për Formimin Vazhdues.”

2. Neni 55 “Trajnerët, ekspertët, moderatorët dhe lehtësuesit e Formimit Vazhdues” ndryshon si vijon:

2.1 Në nenin 55 shtohet në titull koordinatori i moduleve/fushave:

“Trajnerët, ekspertët, koordinatorët e moduleve/fushave, moderatorët dhe lehtësuesit e Formimit Vazhdues”.

2.2 Pika 3 ndryshohen duke reflektuar edhe përzgjedhjen e koordinorëve:

“Listat e trajnerëve/ekspertëve (dhe dokumentacioni i paraqitur), pasi shqyrtohet nga Këshilli Pedagogjik, miratohet nga Këshilli Drejtues dhe i njoftohet çdo aplikanti të miratuar për të filluar përgatitjet. Koordinatorët e moduleve/fushave zgjidhen nga Këshilli Pedagogjik nga lista e trajnerëve/ekspertëve. Magjistratët në detyrë kanë prioritet në përzgjedhje. Shkolla, në bashkëpunim me trajnerët/ekspertët/koordinorët e moduleve/fushave, përgatit marrëveshje për mbarëvajtjen e sesioneve trajnuese dhe të drejtat e detyrimit reciproke”.

3. Aneksin 20 “Rregullore për menaxhimin dhe administrimin e aktiviteteve trajnuese në programin e Formimit Vazhdues”, ndryshon si vijon:

3.1 Shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

“2.1 Në përfundim të modulit, por jo më vonë se në përfundim të vitit akademik, koordinatori harton një raport vlerësimi. Raporti i vlerësimit duhet të përmbajë:

- a) një përshkrim të procesit të ndjekur prej tij;
- b) një vlerësim të tij për ekspertët e përfshirë për çështje të cilat ai ka mundësi të japë vlerësim (përshembull, nëse koordinatori ka patur edhe rolin e ekspertit në 1 apo më shumë trajnime të modulit, ai ka mundësinë të vlerësojë edhe bashkëpanelistët);
- c) një vlerësim për zbatimin plotësisht apo pjesërisht të modulit sipas përshkrimit të miratuar dhe arsyt;
- d) një vlerësim për nevojën për përmirësim/ndryshim/përfundim të nevojës për atë modul.”

3.2 Shtohet pika 3.1 me këtë përmbajtje:

“3.1 Koordinatori i modulit/fushës realizon organizimin e të paktën një takimi të përbashkët me grupin e panelistëve të miratuar për secilin aktivitet trajnues të modulit përpara zhvillimit të trajnimit dhe organizimi i një takimi të përbashkët me grupin e panelistëve në përfundim të trajnimit.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.